



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, TË DREJTAT E NJERIUT DHE
ADMINISTRATËN PUBLIKE
(Komision për dhënie mendimi)

Tiranë më 16.1.2024

Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR MARRJEN E MASAVE URGJENTE PËR MBROJTJEN
DHE PËRMIRËSIMIN E INFRASTRUKTURËS SË UJËRAVE TË NDOTURA QË
DERDHEN NË UJËRA LARËSE”

• ***Hyrje***

Komisioni për Çështjet Ligjore, të Drejtat e Njeriut dhe Administratën Publike, në mbledhjen *online* të datës 16.1.2024, në mbështetje të neneve 26, pika 4, 32-38 dhe 70, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, mori në shqyrtim aktin normativ “Për marrjen e masave për monitorimin, mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së ujërave të ndotura që derdhen në ujëra larëse”.

Deputeti, z. Eduard Ndreca, anëtar i përhershëm në Komisionin për Çështjet Ligjore, të Drejtat e Njeriut dhe Administratën Publike, u caktua relator për këtë akt normativ.

Në mbledhjen e Komisionit, me qëllim prezantimin e nismës ligjore, morën pjesë dhe ishin prezent *online*, përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Më konkretisht:

- përfaqësues të MIE si vijon: znj. Enkelejda Muçaj, zëvendësministër dhe z. Klevis Jahaj, drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Kombëtare Ujësjiellës Kanalizime (AKUK);
- përfaqësues të MTM si vijon: znj. Almira Xhambulla zëvendësministër, znj. Arta Dollani, drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe z. Athanas Karaja, drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme dhe Rregullatore.

- ***Baza kushtetuese e aktit normativ***

Akti normativ nr.8, datë 28.12.2023 “Për marrjen e masave për monitorimin, mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së ujërave të ndotura që derdhen në ujëra larëse”, në zbatim të nenit 101 të Kushtetutës, vjen si propozim i Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave, në rast nevojë, në raste të paparashikuara e urgjence, ushtron të drejtën e nismës ligjore, që do të thotë përjashtimisht gëzon iniciativë legjislative, pra ka të drejtë të nxjerrë akte normative me fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte duhet t’i paraqiten menjëherë Kuvendit të Republikës, i cili ka detyrimin të mbledhet brenda 5 ditëve, edhe nëse nuk është i mbledhur, sepse aktet normative të KM-së duhet të miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve, përndryshe e humbasin fuqinë juridike që prej fillimit.

Në këtë kuptim, në mbështetje të neneve 78 dhe 101, të Kushtetutës, ky akt normativ i paraqitet për shqyrtim dhe miratim Kuvendit.

Në aspektin procedural, akti normativ së bashku me relacionin përkatës, është në përputhje me kërkesat e pikës 2, të nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Ky akt normativ inicohet për shkak të situatës emergjente mjedisore, të krijuar nga subjektet fizike dhe juridike, që ushtrojnë aktivitet ekonomik në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve dhe shkarkojnë ujërat e ndotura në ujëra larëse, pa i trajtuar sipas standardeve. Kjo situatë emergjente u konstatua nga institucionet përgjegjëse për kontrollin e mjedisit, kryesisht gjatë sezonit turistik veror 2023, ku ndotjet e dukshme mjedisore, shkarkimet e pakontrolluara në ujëra larëse dhe problemet me gropat septike, krijojnë një ambient të ndotur, me pasoja për shëndetin e njerëzve dhe me efekt negativ në klimën e turizmit.

Konkretisht, si rezultat i inspektimeve të kryera vetëm gjatë vitit 2023, në subjekte fizike dhe juridike, që ushtrojnë veprimtari ekonomike dhe shkarkojnë ujëra të ndotura, të patrajuara pranë ujërave larëse, janë konstatuar mungesa në ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të kanalizimeve të brendshëm për largimin e ujërave të ndotura të patrajuara deri në kolektor, mungesa në ndërtimin dhe funksionimin e ITUN-eve të nevojshme, në përputhje me kapacitetet përkatëse të trajtimit të ujërave të ndotura të patrajuara, mungesës së trajtimit të llumrave dhe të lëndëve të ngurta, që dalin nga impiantet e trajtimit, shkarkime të pakontrolluara në mjedisin pritës, probleme strukturore të gropave septike, që rezultojnë në rrjedhje të pakontrolluar të ujërave të ndotura në mjedis të hapur.

Nisur nga situata e emergjencës mjedisore e krijuar drejtpërsëdrejt nga subjektet fizike dhe juridike që ushtrojnë aktivitetin ekonomik, të cilët në rang vendi përlllogariten rreth 9 000 persona fizikë dhe juridikë, që ushtrojnë aktivitet ekonomik dhe shkarkojnë ujërat e ndotura të patrajuara pranë ujërave larëse, është nevojë dhe urgjencë sensibilizimi dhe marrja e masave konkrete nga këto subjekte, që të kontribuojnë drejtpërsëdrejt në përmirësimin e situatës mjedisore.

Përveç situatës emergjente të konstatuar në terren dhe mjedis nga strukturat përgjegjëse, në lidhje me trajtimin e ujërave të ndotura, gropat septike, ushtrimi i nismës ligjore nga vetë Këshilli i Ministrave (akti normativ), në mënyrë emergjente, është bërë edhe me qëllimin, që subjektet të plotësojnë standardet e nevojshme për trajtimin e ujërave të ndotura, përpara fillimit të sezonit të ri turistik. Kjo, për shkak se çdo operator do të ketë 90 ditë afat për të plotësuar standardet, që pritet të miratohen sipas parashikimeve të këtij akti normativ.

Më konkretisht, nëpërmjet këtij akti normativ, synohet të menaxhohet situata e emergjencës mjedisore për:

- parandalimin e ndotjes në ujërat larëse dhe mjedisit prej ujërave të ndotura;
- kufizimin e ndikimit, kur ndotja ndodh nëpërmjet ndërtimit të sistemeve individuale të trajtimit të ujërave të ndotura të patrajtuara, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;
- ngritjen e një Task-Force të dedikuar, me qëllim monitorimin, inspektimin dhe marrjen e masave administrative të nevojshme për disiplinimin e shkarkimit të ujërave të ndotura, të pakontrolluara dhe të patrajtuara që derdhen në ujërat larëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- miratimin e rregullave më të hollësishme teknike, me qëllim disiplinimin dhe eliminimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura të patrajtuara në ujërat larëse.

Nëpërmjet këtij akti normativ, në përfundim pritet që subjektet që ushtrojnë aktivitet ekonomik në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve të standardizojnë sipas rregullave në fuqi, trajtimin e ujërave të ndotura. Objektet që janë në proces ndërtimi do të duhet të marrin masat paraprake që në fillim për pasjen e sistemit të trajtimit të ujërave të ndotura.

Në funksion të mbrojtjes së mjedisit, interesit publik dhe zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit dhe vendit në tërësi, nevoja për marrjen e masave për uljen e ndotjes në ujëra larëse në nivele, si të vendeve të Bashkimit Evropian është më se emergjente, përpara se të nisë sezoni i ri turistik.

• ***Vlerësimi i kushtetuteshmërisë së aktit normativ***

Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës. Është pikërisht kjo dispozitë kushtetuese, e cila ka parashikuar në mënyrë të shprehur të drejtën e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte rregullatore me fuqinë e ligjit. Ky tagër kushtetues, dhënë Këshillit të Ministrave, ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta e ka kushtëzuar ushtrimin e tij me ekzistencën e dy kushteve, të nevojës dhe urgjencës, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra. E drejta e Këshillit të Ministrave, për të nxjerrë akte normative me fuqinë e ligjit, duhet që në çdo rast të justifikohet me praninë e rrethanave të veçanta, që e bëjnë të nevojshme ndërmarrjen e nismës urgjente.

Në mbështetje të dispozitave kushtetuese, akti normativ me fuqinë e ligjit, në mungesë të kohës së nevojshme për të filluar një procedurë normale të miratimit të një propozimi për të ndryshuar ligjin, është një instrument legjislativ, që mundëson përshpejtimin e procedurave për nxjerrjen e ligjit.

Gjykata Kushtetuese ka interpretuar kuptimin e kërkesave kryesore të nenit 101, të Kushtetutës¹, ku ka vlerësuar, se nevoja dhe urgjenca janë kushte që varen nga njëra-tjetra në mënyrë të ndërsjellë dhe që lidhen me situata konkrete, me pasojë për vlefshmërinë e aktit normativ, dhe se ekzekutivi është i detyruar të reflektojë ekzistencën e tyre, “...në përmbajtje të çdo akti normativ me fuqinë e ligjit që ai nxjerr, së paku në preambulën e tij...”².

Në vijim, akti normativ ka për qëllim parësor marrjen e masave konkrete të veçanta, që do të zbatohen ndaj subjekteve (rreth 9 000 të tillë), që ushtrojnë aktivitet ekonomik në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve dhe shkarkojnë ujërat e ndotura në ujëra larëse, pa i trajtuar ato sipas standardeve. Kjo dukuri ka shkaktuar **një situatë emergjente mjedisore**, veçanërisht gjatë inspektimeve të realizuara nga organet ligjzbatuese për kontrollin e mjedisit në sezonin turistik veror gjatë vitit 2023, ku ndotja e dukshme mjedisore, shkarkimet e pakontrolluara në ujëra larëse dhe problemet me gropat septike, krijuan një mjedis të ndotur, duke passjellë kështu pasoja për shëndetin e njerëzve, por edhe efekte negative sa i përket klimës së turizmit.

Gjithashtu, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se dhënia e pushtetit ligjvënës Këshillit të Ministrave ka karakter përjashtimor, i cili justifikohet nisur nga fakti se “...në disa situata ose për disa fusha të veçanta, ushtrimi normal i pushtetit ligjvënës kërkon një kohë të caktuar teknike ose, duke konsideruar kompleksitetin e disiplinës në disa sektorë të caktuar, ndërhyrja e ligjvënësit mund të bëhet në një moment të dytë....”³. Ndaj, Gjykata Kushtetuese shprehet, se vetëm kur situata e krijuar vlerësohet e pamundur të presë aq kohë sa nevojitet për nxjerrjen e ligjit të nevojshëm nga organi ligjvënës, qoftë edhe nëpërmjet procedurave të përshpejtuara, nisma ligjvënëse mund t’i kalojë qeverisë⁴ (shih vendimet nr.5, datë 5.2.2014, nr.24, datë 10.11.2006, të Gjykatës Kushtetuese).

Në këto kushte, duke marrë në konsideratë, përpos emergjencës mjedisore, edhe nevojën që kanë subjektet, për kohën e duhur, me qëllim plotësimin e standardeve të kërkuara për trajtimin e ujërave të ndotura, përpara fillimit të sezonit të ri turistik tani në 2024-ën (duke përcaktuar në aktin normativ, se çdo operator do të ketë 90 ditë afat për të plotësuar këto standarde), vlerësojmë se jemi në kushtet e urgjencës dhe të rregullimit të përkohshëm të situatës, pikërisht përmes këtij instrumenti, aktit normativ. Thënë kjo, **vlerësohet e pamundur të pritet aq kohë sa nevojitet për nxjerrjen e një ligji të nevojshëm në këtë rast nga organi ligjvënës, qoftë edhe nëpërmjet procedurave të përshpejtuara, kur sezoni i ri turistik është duke ardhur dhe pritshmëritë për të janë dukshëm në nivele të larta.**

Akti normativ nr.8, datë 28.12.2023 **plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj**, veçanërisht vendimet nr.24, datë 10.11.2006, nr.23, datë 16.4.2014, nr.21, datë 18.4.2023 etj.

¹ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese, nr.24, datë 10.11.2006

² Po aty në vendimin nr.24, datë 10.11.2006, të Gjykatës Kushtetuese

³ Shih vendimin nr.21, datë 18.4.2023, të Gjykatës Kushtetuese

⁴ Po aty, vendimi nr.21, datë 18.4.2023, i GjK

Konkretisht, Gjykata Kushtetuese pohon, se verifikimi i ekzistencës së nevojës dhe urgjencës për nxjerrjen e akteve normative me fuqinë e ligjit, si **kritere kushtetuese** për justifikimin e kësaj forme përjashtimore të veprimtarisë normative, përpos plotësimit të kushteve si vijojnë⁵:

- a) *Nevojës dhe urgjencës si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;*
- b) *Përkohshmërisë së masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit;*
- c) *Fuqisë ligjore të këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre;*
- ç) *Miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi,*

bazohet edhe në :

- i) *vlerësimin e e situatave faktike që i shkaktojnë, pra praninë e rrethanave të veçanta që nuk mund të presin dhe që e bëjnë nevojshme ndërmarrjen e nismës urgjente;*
- ii) *ekzistencën e mjeteve të tjera ligjore që mund të ofronin mundësinë e rregullimit të qëllimeve dhe objektivave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit dhe,*
- iii) *pamundësinë e nxjerrjes së ligjit të nevojshëm nga organi ligjvënës, qoftë edhe nëpërmjet procedurave të përshpejtuara⁶.*

➤ **Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit dhe vlerësimi i situatës faktike**

Neni 101 ka parashikuar nevojën dhe urgjencën si kushte të domosdoshme, që vlerësohen rast pas rasti dhe, që mungesa e tyre passjell pavlefshmërinë e aktit normativ. Emergjencia mjedisore, e shkaktuar si rrjedhojë e ndotjes së mjedisit nga ana e subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve dhe shkarkojnë ujërat e ndotura në ujëra larëse, pa i trajtuar ato sipas standardeve, si dhe duke marrë në konsideratë edhe nevojën që kanë këto subjektete, për t'u përshtatur me rregullimin e ri ligjor dhe kohën që u duhet për të marrë masat, për plotësimin e standardeve të kërkuara për trajtimin e ujërave të ndotura, përpara fillimit të sezonit të ri turistik, për të parandaluar ndotjen mjedisore, **konsiderohet si shkak për urgjencë**. Pikërisht, nisur nga situata e emergjencës mjedisore, e krijuar drejtpërsëdrejt nga subjektet fizike dhe juridike që ushtrojnë aktivitetin ekonomik, të cilët në rang vendi përlllogariten rreth 9 000 persona fizikë dhe juridikë, që ushtrojnë aktivitet ekonomik dhe shkarkojnë ujërat e ndotura të patrajuara pranë ujërave larëse, **është nevojë dhe urgjencë sensibilizimi dhe marrja e masave konkrete** nga këto subjekte, që brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ, të vendosin impiantin ose sisteme individuale, me qëllim trajtimin e ujërave të ndotura, sipas rregullores teknike, duke kontribuar drejtpërsëdrejt në përmirësimin e situatës mjedisore, në prag të sezonit të ri turistik.

➤ **Përkohshmëria**

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45-ditore. Përkohshmëria e këtij akti normativ lidhet me kushtin e domosdoshmërisë së shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili, nëse e miraton, e kthen atë në ligj.

⁵ Vendimi nr.24, datë 10.11.2006, i Gjykatës Kushtetuese.

⁶ Shih vendimin nr. 21, date 18.4.2023, të Gjykatës Kushtetuese

Në përfundim, akti normativ vlerësohet, se është një akt që del pikërisht në kushtet e nevojës dhe të urgjencës dhe, ai i plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimet nr.24 datë 10.11.2006, nr.23 datë 16.4.2014, nr.21 dhe datë 18.4.2023.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis të BE-së***

Akti normativ nuk synon përafrimin me legjislacionin parësor apo dytësor të Bashkimit Evropian, por është në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, në fushën e politikave të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të tij, sipas parimeve dhe modelit të BE-së në këtë fushë veprimtarie.

- ***Konsultimi***

Në mbështetje të pikës 2/1, të nenit 68, të Rregullores së Kuvendit, gjatë shqyrtimit të këtij akti normativ, Komisioni nuk ka zhvilluar proces konsultimi në kuptim të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, por ka bashkërenduar dhe është konsultuar me përfaqësuesit e ministrive të linjës, kryesisht të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, që janë edhe ndër institucionet e ngarkuara me ndjekjen dhe zbatimin e aktit normativ në praktikë.

- ***Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm***

Në mbështetje të shkronjës “d”, të pikës 2, të nenit 68, të Rregullores së Kuvendit, në relacionin shoqërues të aktit normativ nuk përshkruhet në mënyrë të drejtpërdrejt përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga Agjenda 2030 e Kombeve të Bashkuara për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Në zbatim të këtij parashikimi, në mënyrë të posaçme, miratimi i këtij akti normativ lidhet me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe konkretisht, ky akt normativ është në përputhje me Objektivin nr.6, “Uji i pastër dhe kanalizime për të gjithë. Sigurimi i aksesit në furnizimin me ujë dhe kanalizimeve për të gjithë” dhe objektivin nr.14 “Jeta nën ujë. Ruajtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i oqeanëve, deteve dhe burimeve detare për zhvillim të qëndrueshëm, i cili ndër të tjera synon përmirësimin e cilësisë së ujit, duke ulur ndotjen, duke ndaluar hedhjen e mbetjeve në mënyrë të pakontrolluar dhe minimizimi i çlirimit të kimikateve dhe materialeve të rrezikshme, duke përgjysmuar përqindjen e ujërave të zeza të patrajtura dhe, duke rritur ndjeshëm riciklimin dhe ripërdorimin e sigurt në nivel global, zbatimin e menaxhimit të integruar të burimeve ujore në të gjitha nivelet, zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe mbështetja për ndërtimin e kapaciteteve për vendet në zhvillim në aktivitetet dhe programet e lidhura me ujin dhe kanalizimet, duke përfshirë mbledhjen e ujit, shkripëzimin, përdorimin efikas të ujit, trajtimin e ujërave të zeza, riciklimin dhe teknologjitë e ripërdorimit, parandalimin dhe uljen domethënëse e ndotjes ujore të të gjitha llojeve, veçanërisht nga aktivitetet tokësore, duke përfshirë mbetjet ujore dhe ndotjet nga lëndët, rritjen e përfitimeve ekonomike për shtetet në zhvillim dhe vendet më pak të zhvilluara nga përdorimi i qëndrueshëm i burimeve detare, duke përfshirë menaxhimin e qëndrueshëm të peshkimit, akuakulturës dhe turizmit, etj.

- ***Institucionet zbatuese***

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit, Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe institucionet përgjegjëse për dhënien e lejeve përkatëse, për kryerjen e plotësimeve të standardeve për trajtimin e ujërave të ndotura, janë institucionet e ngarkuara për ndjekjen dhe zbatimin e këtij akti normativ.

- ***Efektet financiare***

Ky akt normativ sjell efekte financiare me ngritjen e Task-Forcës. Me qëllim funksionimin e kësaj strukture, përllogaritet një buxhet i barasvlefshëm me 323 860 000 lekë, i cili do të përballohet nga fondet rezervë të Komisionit të Ministrave për vitin 2024, i ndarë, në:

- shpenzime kapitale (kompjutera, mjete, pajisje monitorimi dhe testimi, sisteme + pajisje tablet, pajisje zyre etj.);
- shpenzime operative (paga dhe sigurime shoqërore për një numër punonjësish në total 48, shpenzime udhëtimi, dieta, materiale printimi, procesverbale, fushatat e informimit, qira zyre, energji, trajnime, kancelari etj).

Struktura e posaçme për monitorimin mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së ujërave të ndotura që shkarkohen në ujërat larëse është një politikë e re, e cila nuk është e parashikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, por krijimi i kësaj strukture është i nevojshëm dhe emergjent, në kushtet e zhvillimit të vrullshëm të turizmit gjatë vitit 2023 dhe, pritshmërive për zhvillimin dhe turizmin gjatë vitit 2024.

- ***Të ardhurat***

Struktura e posaçme ka si qëllim marrjen e masave për subjektet, të cilat kryejnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve dhe nuk trajtojnë ujërat e ndotura të krijuara nga aktiviteti i tyre. Nga veprimtaria e strukturës së posaçme parashikohet të arkëtohen të ardhura nga gjërat për ato subjekte që nuk zbatojnë ligjin. Të ardhurat nga vendosja e masave administrative arkëtohen në buxhetin e shtetit.

- ***Çështje të diskutuara në Komision***

Në mbledhjen e Komisionit, me qëllim prezantimin e aktit normativ, si dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve të deputetëve, anëtarë të Komisionit, ishin prezent *online*, përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Znj.Enkelejda Muçaj, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, në mënyrë të përmblodhur, në fjalën e saj u ndal në qëllimin e aktit normativ dhe rëndësinë që paraqet miratimi i tij nga ana e Kuvendit. Znj.Muçaj bëri një prezantim të shkurtër të aktit normativ, të qëllimit, përmbatjes dhe efekteve që sjell miratimi i tij. Ajo e cilësoi aktin normativ, si një nevojë për t'u përballur me situatën e emergjencës mjedisore, të shkaktuar nga subjektet fizike dhe juridike (janë rreth 9 000

të tillë), që ushtrojnë aktivitet ekonomik në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve dhe shkarkojnë ujërat e ndotura në ujëra larëse, pa i trajtuar ato sipas standardeve. Znj. Muçaj solli në vëmendje të komisionit, se si rezultat i inspektimeve të kryera vetëm gjatë vitit 2023, në subjekte fizike dhe juridike, që ushtrojnë veprimtari ekonomike dhe shkarkojnë ujëra të ndotura, të patrajuara pranë ujërave larëse, janë konstatuar mungesa në ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të kanalizimeve të brendshëm për largimin e ujërave të ndotura të patrajuara deri në kolektor, mungesa në ndërtimin dhe funksionimin e ITUN-eve të nevojshme, në përputhje me kapacitetet përkatëse të trajtimit të ujërave të ndotura të patrajuara, mungesës së trajtimit të llumrave dhe të lëndëve të ngurta, që dalin nga impiantet e trajtimit, shkarkime të pakontrolluara në mjedisin pritës, probleme strukturore të gropave septike, që rezultojnë në rrjedhje të pakontrolluar të ujërave të ndotura në mjedis të hapur. Për këtë qëllim theksoi ajo, ky akt normativ parashikon ngritjen e një strukture të posaçme, Task-Forcës për monitorimin, inspektimin dhe marrjen e masave administrative të nevojshme për disiplinimin e shkarkimit të ujërave të ndotura, të pakontrolluara dhe të patrajuara që derdhen në ujërat larëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ngritja e kësaj strukture passjell efekte financiare në zbatimin e aktit normativ, efekte që llogariten në vlerën e 323 860 000 lekë, buxhet ky që do të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për vitin 2024.

Në fjalën e tij, relatori, z. Ndreca, pasi bëri një prezantim të aktit normativ, u ndal në qëllimin dhe rëndësinë, që bart miratimi i tij nga ana e Kuvendit, për shkak të rëndësisë që paraqet zhvillimi i sektorit të turizmit në vendin tonë, si një nga sektorët jetikë dhe prioritarë për zhvillimin e ekonomisë shqiptare, e dëshmuar kjo më së miri me hovin që pësoi kjo degë e ekonomisë përgjatë vitit 2023, veçanërisht gjatë sezonit turistik veror.

Gjithashtu, z. Ndreca u shpreh, se ky akt normativ, adreson në mënyrë të qartë edhe problematikat që kanë hasur banorët e zonave të qarkut Lezhë, të cilët në vijëmbësi kanë shprehur shqetësimin e tyre për ndotjen e mjedisit dhe të brigjeve të lumenjve dhe detit, si pasojë e ngritjes së disa fabrikave të përpunimit të mishit, peshkut, etj, në këtë qark. Ai theksoi, se këtë shqetësim të këtij komuniteti e ka bërë prezent qysh në krye të herës edhe në parlament dhe, miratimi i këtij akti normativ, është jo vetëm adresim dhe zgjidhje, por edhe një këmbanë për autoritetet në nivel vendor, për forcimin e mekanizmave të kontrollit, inspektimit dhe monitorimit të këtyre subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike që shkarkojnë ndotje të mjedisit.

Relatori në përfundim të fjalës së tij, u shpreh, se akti normativ është në përputhje me Kushtetutën, vlerësoi rëndësinë e miratimit të tij dhe u kërkoi kolegëve deputetë ta miratojnë aktin normativ në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, si dhe t'i përcillet komisionit përgjegjës për vijimin e procedurës së miratimit sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Në përfundim, kryetari i Komisionit për Çështjet Ligjore, të Drejtat e Njeriut dhe Administratën Publike, znj. Bushka theksoi rëndësinë që paraqet miratimi i aktit normativ në drejtim të përmirësimit të situatës së emergjencës mjedisore dhe përcaktimit të masave konkrete për të gjithë ata subjekte, që ushtrojnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve, për trajtimin e ujërave të ndotura dhe shkarkimin e tyre sipas standardeve të kërkuara nga legjislacioni në fuqi. Ajo solli në vëmendje të komisionit, se ky legjislacion është i plotë dhe koherent dhe kërkon pikërisht marrjen e masave, për zbatimin e tij korrekt në praktikë. Referuar parimit proporcional, për aplikimin e masave legjislative, të cilat shkarkojnë humbje minimale te

subjektet ndaj të cilëve aplikohen, por përfitim të madh ndaj shoqërisë në drejtim të interesit publik, sa ç'është e drejtë e subjekteve ekonomike ushtrimi i veprimtarisë ekonomike në këtë drejtim, është po ashtu edhe e drejtë e qytetarëve për të jetuar e zhvilluar në një mjedis të shëndetshëm e të denjë.

Znj. Bushka gjithashtu, theksoi, se Kuvendi do të vijojë monitorimin e zbatimit të aktit normativ, sa i përket marrjes së masave konkrete dhe aplikimit të sanksioneve administrative, si rrjedhojë e inspektimeve dhe monitorimeve në terren, nga ana e institucioneve përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin në praktikë të aktit normativ.

- ***Përfundime***

Komisioni për Çështjet Ligjore, të Drejtat e Njeriut dhe Administratën Publike, pasi e shqyrtoi aktin normativ, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, me shumicë votash (14 vota pro) e miratoi atë dhe u shpreh se:

Në aspektin kushtetues dhe ligjor, akti normativ me fuqinë e ligjit kontrollohet nga Kuvendi, i cili bën vlerësimin në formë dhe përmbajtje të normës dhe elementeve përbërëse të saj, si dhe në shprehjen e mendimit përfundimtar lidhur me aktin normativ, si dhe pajtueshmërinë e përmbajtjes së tij me Kushtetutën dhe ligjet e tjera në fuqi. Në këto kushte, akti normative nr.8, datë 28.12.2023, i propozuar si nismë e Këshillit të Ministrave, është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, duke vlerësuar se ai plotëson kushtet e nevojës dhe emergjencës, si parakushte thelbësore për përdorimin e këtij instrumenti legjislativ.

Në aspektin material dhe procedural, akti normativ në formë dhe përmbajtje është në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, sa i takon rregullave dhe procedurave të parashikuara për mënyrën e paraqitjes për shqyrtim dhe miratim të nismave ligjore në Kuvend.

RELATOR

Eduard NDRECA

KRYETAR

Klotilda BUSHKA